

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6181  
E enjte, 3 dhjetor 2020  
çmimi 0.40 €

## Qeveria Hoti nën "Ilupën" e Gjykatës Kushtetuese | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) KËRKON SEANCË TË JASHTËZAKONSHME  
PËR PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE | FAQE 4

# PDK-ja DO TA PËRKRAHË PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE

Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka treguar se kjo parti do ta përkrahë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike pasi janë përfshirë propozimet e saj në këtë projektligj. Ai ka thënë se propozimet e PDK-së përfshijnë themelimin e një fondi të veçantë i cili do të shërbejë për t'i paguar të gjithë të punësuarit në sektorin privat, themelimin e një granti për ndihmë të drejtpërdrejtë financiare për biznese, si dhe të gjithë qytetarët që kanë kontribuar në Trustin Pensional të Kosovës deri në shumën 10 mijë euro, në rast të tërheqjes së shumës 10 për qind, qeveria do t'ua kompensojë ato



PDK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

PDK



## KOSOVA, DEPONI MBETURINASH MINERARE QË PËRHAPIN HELM | FAQE 8, 9, 10

## DIALOGU KOSOVË - SERBI, PJESË E STRATEGJISË SË BE-së PËR RAPORTET ME SHBA-në | FAQE 3



### OPINION

## GJYKATA SPECIALE, PROVIMI MË I VËSHITËRË NË 20 VJETËT E FUNDIT I DIPLOMACISË SË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS | F. 11

Nga Msc. Iur. Anton  
Luljuraj, Mal i Zi



### AKTUALE



## EDHE 14 TË VDEKUR NGA COVIDI NË KOSOVË | F. 7

## INTERPOLI: VAKSINAT KUNDËR COVID-19 MUND TË JENË NË SHËNJESTËR TË GRUPEVE KRIMINALE | F. 2

### EKONOMI

## REÇICA DHE BANKA BOTËRORE DISKUTOJNË PËR MBËSHETJEN E FAMILJEVE TË VARFRA NË KOSOVË | F. 7



### SPORT

## PEJA REGJISTRON FITOREN E KATËRT RADHAZI | F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Interpoli: Vaksinat kundër Covid-19 mund të jenë në shënjestër të grupeve kriminale

LYON, 2 DHJETOR - Organizata Ndërkombëtare e Policisë (INTERPOL) paralajmëroi të mërkurën se rrjetet e organizuara kriminale mund ta synojnë shitjen e vaksinave false kundër koronavirusit. Interpol, me seli në Francë, tha se kishte lëshuar një alarm global për zbatimin e ligjit në 194 vendet e tij anëtare, duke i paralajmëruar ata që të përgatiten për rrjetet e krimit të organizuar që synojnë vaksinat Covid-19, si fizikisht ashtu edhe në internet. "Derisa qeveritë po përgatiten t'i shpërndajnë vaksinat, organizatat kriminale po planifikojnë të infiltrojnë

ose t'i prishin zinxhirët e furnizimit", ka thënë sekretari i përgjithshëm i Interpolit, Juergen Stock.

Të mërkurën Mbretëria e Bashkuar është bërë vendi i parë në botë që miraton vaksinën kundër Covid-19 të kompanisë "Pfizer" dhe "BioNTech".

Ka disa vaksina të tjera premtuese që, gjithashtu, mund të miratohen së shpejti. Një nga ato është ajo e kompanisë "Moderna" e cila përdor të njëjtën qasje si vaksina e "Pfizer" dhe ofron mbrojtje të ngjashme. Edhe Universiteti i Oksfordit në

bashkëpunim me "AstraZeneca" kanë zhvilluar një vaksinë.

Rusia ka përdorur një tjetër vaksinë, të quajtur "Sputnik", dhe ushtria kineze ka miratuar një tjetër të bërë nga "CanSino Biologics". Derisa pandemia e koronavirusit po shtohet në pjesën më të madhe të botës, vendet po përpiqen të sigurojnë furnizime të mundshme të vaksinave dhe po përgatisin plane për veprimet e para që do të ndërmarrin në javët e ardhshme.

Shpresat janë të mëdha se vaksinat mund të jenë gati për përdorim para fundit të vitit, me



dy vaksina kryesore nga "Moderna" dhe "BioNTech/Pfizer", që tashmë

kanë kërkuar miratimin për përdorim emergjent në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë.

## Në ShBA po hetohet një skemë ryshfeti që përfshin Shtëpinë e Bardhë



WASHINGTON, 2 DHJETOR - Departamenti i Drejtësisë në Shtetet e Bashkuara po heton një skemë të mundshme të ryshfetit që përfshin kontribute politike në këmbim të faljes presidenciale, sipas disa dokumenteve të gjykatës.

Dokumentet e gjykatës janë redaktuar para se të publikohen dhe emrat e të dyshuarve janë fshirë me ngjyrë të zezë. Nuk ka asnjë referencë për presidentin amerikan Donald Trump ose për fushatën e tij. Por, dokumentet i referohen një "skeme të fshehtë

lobimi" nga dy individë, të bërë ndaj "zyrtarëve të lartë të Shtëpisë së Bardhë" për të fituar "falje ose heqjen e dënimit" nga presidenti për një individ të paemëruar.

Të dyshuarit, një nga ata që është avokat, përmendën "kontribute të konsiderueshme të fushatës së kaluar" dhe "pritje të kontributeve thelbësore politike në të ardhmen" në këmbim të faljes presidenciale ose heqjes së dënimit, thuhet në dokumente. Është e paqartë se si zyrtarët e Shtëpisë së Bardhë iu

përgjigjen ofertës së supozuar të ryshfetit. Gjykatësja e Qarkut në Uashington, Beryl Howell, lëshoi dokumentet e redaktuara në një urdher që ajo e përshkroi si një hetim "ryshfeti për falje" i cili ka vazhduar të paktën që nga muaji gusht.

Presidentët kanë autoritet të gjerë kushtetues për të ofruar falje federale dhe praktika është e zakonshme. Me vetëm disa javë të mbetura në presidencën e tij, Trump pritet të shpallë një mori faljesh, përfshirë edhe ndaj aleatëve politikë.

## Rusia vendos raketa në ishujt që pretendohen nga Japonia

Moskë, 2 dhjetor - Ushtria ruse ka njoftuar për vendosjen e raketave të mbrojtjes ajrore në Ishujt Kurile mbi të cilat ka pretendime Japonia. Sistemet e raketave të mbrojtjes ajrore S-300V4 janë vendosur në gatishmëri luftarake në Ishujt Kurile, përveç sistemeve të raketave me rreze më të shkurtër Tor M2 të vendosura atje më herët, tha Qarku Ushtarak Lindor i Rusisë përmes një deklarate.

Stacioni televiziv i ministrisë ruse të Mbrojtjes, Zvezda, raportoi se sistemet e raketave të mbrojtjes

ajrore ishin vendosur në Iturup, një nga katër ishujt jugorë të Kurileve. Rusia ka vazhduar t'i ndërtojë forcat e saj në ishuj, duke përfshirë stacionimin e avionëve luftarakë të përparuar dhe raketave anti-anije.

Bashkimi Sovjetik okupoi rajonin nga Japonia në ditët e fundit të Luftës së Dytë Botërore. Japonia vazhdon të pretendojë të drejtat territoriale në ishujt të cilat i quan Territoriet Veriore.

Mosmarrëveshja ka penguar Rusinë dhe Japoninë të nënshkruajnë një traktat paqej

që i jep fund zyrtarisht luftës. Dekada përpjekjesh diplomatike për të negociuar një zgjidhje nuk kanë dhënë ndonjë rezultat.

Tokio është shumë e ndjeshme ndaj lëvizjeve ushtarake nga Moska në zinxhirin strategjik të rëndësishëm të ishujve që shtrihen në verilindje nga Hokkaido i Japonisë në rajonin Kamchatka të Lindjes së Largët Ruse.

Menjëherë pas marrjes së detyrës në shtator, kryeministri japonez, Yoshihide Suga, diskutoi për mosmarrëveshjen territoriale



përmes një telefonate me presidentin rus Vladimir Putin. Ish-kryeministri japonez Shinzo

Abe shtyu zgjidhjen e mosmarrëveshjes gjatë gati tetë vjetëve të tij në pushtet.

## Franca do të kryejë kontrole kufitare për ta ndaluar skijimin jashtë shtetit



PARIS, 2 DHJETOR - Kontrole të zakonshme kufitare do të nisin së realizuari për t'i ndaluar francezët që të mos shkojnë në shtetin fqinj, Zvicër, për skijim, ka thënë

kryeministri i Francës, Jean Castex.

Franca, bashkë me Gjermaninë dhe Italinë, janë duke ndalur punën e teleferikëve në kohën e

Krishtlindjes për ta ndaluar përhapjen e koronavirusit, mirëpo në Zvicër qendrat e skijimit veçse janë të hapura. Sezona e skijimit për Krishtlindje dhe Vitin e Ri

është periudhë e rëndësishme për ekonominë e shumicës së vendeve evropiane. Castex ka thënë se është detyra e tij që t'i mbrojë qytetarët.

# Dialogu Kosovë - Serbi, pjesë e strategjisë së BE-së për raportet me ShBA-në

**EPOKA  
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Komisioni Evropian ka miratuar në takimin e së mërkurës (2 nëntor) të kolegjit të komisionarëve një strategji për agjendën e re të raporteve transatlantike, më saktësisht raporteve në mes të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Komisioni në këtë dokument nënvizon nevojën për bashkëpunim me

Shtetet e Bashkuara për ta forcuar rendin multilateral botëror dhe për t'u përballur së bashku me sfidat e reja, nga përhapja e koronavirusit e deri te forcimi i mbrojtjes dhe sigurisë. Në këtë agjendë strategjike të Komisionit Evropian përmendet edhe nevoja që BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara ta vazhdojnë bashkëpunimin edhe në Ballkanin Perëndimor, sidomos në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Evropa i ka dhënë Ballkanit Perëndimor

perspektivë të anëtarësimit në BE. Vazhdimi i partneritetit në mes të BE-së dhe ShBA-së dhe koordinimi i afërt në Ballkanin Perëndimor është thelbësor, posaçërisht në dialogun në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Ne duhet të punojmë së bashku për ta mbështetur pajtimin, përmirësojmë qeverisjen dhe t'i shtyjmë përpara reformat kyçe", thuhet në tekstin e strategjisë së Komisionit Evropian për raportet mes BE-së dhe Shteteve të

Bashkuara. Bashkimi Evropian planifikon që të mbajë një samit mes BE-së dhe Shteteve të Bashkuara në pjesën e parë të vitit 2021. Në BE fitoren e Joe Bidenit në zgjedhjet presidenciale amerikane e shohin si një rast për t'i forcuar marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara dhe për ta rritur bashkëpunimin në shumë fusha, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me ruajtjen e mjedisit dhe tregtinë.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011 nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Ky dialog ka për qëllim normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes dy vendeve. Së fundmi, Shtetet e Bashkuara kanë shtuar përpjekjet e tyre për t'i afruar palët drejt normalizimit të raporteve dhe në këtë kuadër, më 4 shtator, në Shtëpinë e Bardhë në Uashington, Kosova dhe Serbia nënshkruan marrëveshje për normalizim ekonomik.



## Nëse jo Haradinaj president, Kosova shkon drejt zgjedhjeve të parakohshme



PRISHTINË, 2 DHJETOR - Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka komentuar situatën dhe zhvillimet politike në "Euronews Albania". Ai ka thënë se "ish-kryeministri Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje gjejnë të përbashkëta duke thënë, se vendi në këtë situatë, siç e cilësojnë ata kaotike, ka nevojë për një zgjidhje dhe zgjidhja është të zgjedhjet e parakohshme". Por për Tahirin opozita gjithmonë kërkon zgjedhje. "Ne kemi qenë si

aleancë në opozitë dhe e dimë se opozita gjithmonë do zgjedhje dhe është gjithmonë e natyrshme", u shpreh Tahiri. Ai beson se zgjidhja më e mirë për Kosovën është që ish-kryeministri Haradinaj të bëhet president i Kosovës. "Ne kemi qenë shumë të drejtpërdrejtë dhe të sinqertë në momentin kur ka pasur një krizë politike, ne e kemi ofruar Ramush Haradinaj për kandidat për president. Unë këtë javë do t'i takoj partnerët e koalicionit, me të cilët do të diskutojmë këtë temë, pra po flas

për Lidhjen Demokratike të Kosovës, pastaj Nismën dhe AAK-në, me të cilat do të sqarohet mbështetja ndaj Haradinajt", tregon Tahiri. Partia e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj duket e vendosur për pozitën e presidentit, ndërsa zëvendëskryeministri Tahiri nuk e përjashton mundësinë që Kosova të shkojë drejt zgjedhjeve të parakohshme nëse nuk do të kishte reflektim dhe konsensus nga forcat e tjera politike për ta pranuar alternativën e propozuar nga AAK-ja.

## Grupi parlamentar i Nismës rritet edhe me katër deputetë

Prishtinë, 2 dhjetor (ER) - Grupit parlamentar të Nismës Socialdemokrate dhe AKR-së i

janë bashkuar edhe katër deputetë të ish-Grupit Parlamentar 6+. Deputetët që i

janë bashkuar këtij grupi janë Duda Balje, Fikrim Damka, Fidan Jilta dhe Albert Kinolli. Tashmë ky

grup parlamentar prej dhjetë deputetësh do të quhet grupi parlamentar Nisma-AKR-6+.





PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) KËRKON SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE

# PDK-ja DO TA PËRKRAHË PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE

Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka treguar se kjo parti do ta përkrahë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike pasi janë përfshirë propozimet e saj në këtë projektligj. Ai ka thënë se propozimet e PDK-së përfshijnë themelimin e një fondi të veçantë i cili do të shërbejë për t'i paguar të gjithë të punësuarit në sektorin privat, themelimin e një granti për ndihmë të drejtpërdrejtë financiare për biznese, si dhe të gjithë qytetarët që kanë kontribuar në Trustin Pensional të Kosovës deri në shumën 10 mijë euro, në rast të tërheqjes së shumës 10 për qind, qeveria do t'ua kompensojë ato

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se ky subjekt politik ka nisur mbledhjen e nënshkrimeve të deputetëve për të ftuar seancë të jashtëzakonshme për ta votuar Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, ku janë përfshirë propozimet e PDK-së të cilat ndihmojnë punëtorët e sektorit privat dhe bizneset me mbi 400 milionë euro buxhet.

Në një konferencë për media ai ka thënë se PDK-ja tanimë ka propozuar katër masa konkrete të cilat, nëse pranohen nga qeveria, kjo parti do ta votojë Ligjin e Rimëkëmbjes Ekonomike. "Ne e kuptojmë shqetësimin dhe nevojën tuaj dhe, po ashtu, kemi gatishmërinë që edhe nga opozita t'ju ndihmojmë siç ju kemi ndihmuar gjithmonë edhe kur kemi udhëhequr vendin. Partia Demokratike e Kosovës tanimë ka

propozuar pesë masa konkrete të cilat, nëse pranohen nga qeveria, Partia Demokratike e Kosovës do ta votojë Ligjin e Rimëkëmbjes Ekonomike. Propozimet tona janë ndihma konkrete për qytetarët dhe bizneset dhe kapin shumën mbi 400 milionë euro", ka deklaruar ai.

Hoxhaj ka treguar se masa e parë është që të themelohet një fond i veçantë i cili do të shërbejë për t'i paguar të gjithë të punësuarit në sektorin privat që kanë humbur vendet e tyre të punës si pasojë e pandemisë së koronavirusit. "Pra, të gjithë punëtorët e sektorit privat të regjistruar si të pa punë, e që kanë qenë në marrëdhënie pune deri në shtator 2020, por që nga muaji tetor 2020 janë liruar nga punëdhënësi si pasojë e ndikimit të Covid-19, do të paguhet nga ana qeveria së paku tre deri në katër muaj përkatës me nga 300 euro në muaj. Të themelohet granti në shumë prej 200 milionë eurosh për ndihmë të drejtpërdrejtë financiare për bizneset të cilat kanë vështirësi të

funkcionimit si rezultat i ndikimit të Covid-19", ka vlerësuar Hoxhaj, duke shtuar se këto mjete të grantit do t'u shpërndahen të gjitha bizneseve sipas kriterëve dhe kushteve të caktuara nga ana e një komisionit të posaçëm i cili do të themelohet ekskluzivisht për këtë çështje nga Qeveria e Kosovës, të cilat dëshmojnë se e kanë të vështirë zhvillimin e afarizmit si pasojë e ndikimit të Covid-19.

Sipas tij, masa e tretë ka të bëjë me Trustin, kurse e katërta me TVSh-në. "Të gjithë qytetarët që kanë kontribuar në Trustin Pensional të Kosovës deri në shumën 10 mijë euro, në rast të tërheqjes së shumës 10 për qind nga ana e tyre, Qeveria e Kosovës do ta kompensojë te Trusti brenda pesë vjetëve të ardhshëm në mënyrë që ata qytetarë t'i kenë mjetet e tyre për moshën e pleqërisë. Qeveria e Kosovës duhet ta lirojë nga TVSh-ja lëndën e parë e cila prodhohet nga bizneset e Kosovës, pavarësisht a eksportohet jashtë vendit apo jo",

është shprehur Hoxhaj.

Ndërsa masa e pestë ka për qëllim rritjen e transparencës për ta përcjellë efektin e këtyre masave, duke shtuar se PDK-ja kërkon që të njëjtat të jenë të specifikuar qartë në kuadër të ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2021. "Besojmë që kontribut në këtë drejtim do të japin deputetët në Kuvendin e Kosovës dhe asociacionet përfaqësuese të bizneseve. Ne presim që të gjitha partitë parlamentare ta mbështesin këtë iniciativë të PDK-së dhe ta nënshkruajnë nismën tonë për seancë të jashtëzakonshme që ta miratojmë Ligjin e Rimëkëmbjes Ekonomike brenda kësaj jave dhe qytetarët e Kosovës ta marrin ndihmën e merituar shtetërore, sipas mundësive buxhetore që ka vendi ynë", ka thënë ai. Hoxhaj ka treguar se seanca për miratimin e këtij projektligji mund të mbahet të premten, më 4 nëntor.

## Kandidati për president duhet të jetë i PDK-së

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se ky subjekt politik nuk do ta mbështetë asnjë kandidat për presidenti i cili vjen nga partitë në pushtet. Në një konferencë për media ai ka thënë se kjo parti është e gatshme të bisedojë për çështjen e presidentit me partitë në pushtet. "Që ta kuptoni drejt qasjen tonë, PDK-ja është në

opozitë, mbetet në opozitë, por janë 4-5 tema të cilat janë të karakterit nacional, ku kërkohet konsensus nacional. Një temë e tillë është edhe pakoja e rimëkëmbjes ekonomike. Temë e dytë është edhe zgjedhja e presidentit. Presidenti i cili zgjidhet në Kuvendin e Kosovës nuk është vetëm president i partive që janë në qeveri, i shumicës parlamentare. Ai është president edhe i opozitës dhe i të gjithë qytetarëve të Kosovës", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka treguar se nëse partitë në pushtet i kërkojnë votat e PDK-së për këtë çështje, atëherë kandidati për president duhet të jetë nga kjo parti. "Prandaj, nëse ka kërkesa prej kolegëve që janë në qeveri që ta marrin mbështetjen e PDK-së, ne jemi të gatshëm që të ulemi dhe të bisedojmë. Por në atë rast, kur kërkohen votat e PDK-së, edhe kandidati duhet të jetë i Partisë Demokratike të Kosovës. Ne e dimë se presidenti i vendit është kreu i shtetit, por ju e dini se këtë mandat e ka pasur presidenti Thaçi, i cili në të kaluarën ka qenë kryetar i PDK-së, që ka hequr dorë prej kryetarit të partisë dhe është bërë president i vendit. Dhe nëse dikush kërkon mbështetje të PDK-së, duhet ta dijë se Gjykata Speciale ia ka ndërprerë atij mandatin dhunshëm dhe ne duam që me vota të PDK-së ky mandat t'i takojë PDK-së. Nuk kemi vota për asnjë kandidat që vjen prej partive në pushtet", ka deklaruar Hoxhaj.

# QEVERIA HOTI NËN 'LLUPËN' E GJYKATËS KUSHTETUESE

Prishtinë, 2 dhjetor - Gjykata Kushtetuese mbajti seancë dëgjimore lidhur me kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje për shpalljen të pavlefshme të votimit për zgjedhjen e qeverisë Hoti më 3 qershor, pasi për këtë qeveri kishte votuar edhe deputeti Etem Arifi i cili kishte një aktgjykim përfundimtar nga Gjykata e Apelit, më 20 gusht 2019, ku ishte dënuar me 1 vjet e 3 muaj burgim për mashtrim me subvencione. "Ne si grup parlamentar mendojmë se z. Arifi, që nga fshehja e informatave e deri te votimi i qeverisë, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Vota e Etem Arifit duhet të shpallet e pavlefshme dhe vendimi i Kuvendit kundërkushtetues", ka thënë përfaqësuesi ligjor i Lëvizjes Vetëvendosje në këtë seancë, Blerim Sallahu. Ai shtoi se vota e deputetit Arifi nga Partia e Ashkalinjve për Integrim ka qenë vendimtare, ndërkaq në bazë të dokumentacionit të ofruar, "konstatohet se ish-deputeti Arifi ka gënjer dhe e ka mbajtur të fshehur faktin se ka aktgjykim të formës së prerë". "Prandaj, ne konsiderojmë se procedura në Kuvend më 3 qershor është ezauruar dhe se tani duhet të shpallen zgjedhjet e jashtëzakonshme", tha Sallahu, raporton Rel.

Ndërkaq përfaqësuesi ligjor i Qeverisë së Kosovës, avokati Besnik Berisha, e cilësoi të pabazë kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje, pasi në këndvështrimin e tij deputeti Arifi nuk kishte dënim që ia mohonte të drejtën e zgjedhjes dhe se vendimi i gjykatës ishte subjekt i legjislaturës së kaluar. "Ish-

deputeti Arifi e ka humbur mandatin e deputetit në legjislaturën e gjashtë. Pasoja e këtij vendimi janë ekzekutuar dhe kanë pasur fuqi në mandatin e gjashtë. Është e parëndësishme kur është njoftuar Kuvendi", tha avokati Berisha.

Avokati Berisha iu referua edhe çështjes së shumicës në Kuvend, e cila, sipas tij, nuk cenohet as në rast se kontestohet vota e deputetit Arifi. "Nëse deputeti Arifi nuk ka pasur të drejtë zgjedhjeje në Kuvend, atëherë i bie që në Kuvend kanë qenë 119 deputetë. Edhe në këtë rast shumica parlamentare është 60", tha ai.

Përfaqësuesi i Kuvendit të Kosovës në këtë seancë dëgjimore, Artan Murati, tha se Kuvendi është njoftuar për vendimin e gjykatës për deputetin Etem Arifi në prill të këtij viti dhe se më tej janë ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme. Sipas tij, mungesa e informimit në kohë po shkakton telashe të tilla. Shkëmb Manaj, kryetar i Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Kosovës, kishte qëndrim të njëjtë me përfaqësuesin e qeverisë, duke thënë se vlerësimi i tij, i dhënë edhe në mbledhjet e Komisionit, është se "një deputet humb mandatin vetëm nëse dënohet me burgim gjatë atij mandati" që, sipas tij, nuk është rasti tek Arifi.

## S'përputhje në mes të ligjit dhe vendimit gjyqësor

Shumica e pjesëmarrësve në këtë seancë dëgjimore ngritën shqetësimin se si KQZ-ja nuk e ka

verifikuar të kaluarën e deputetit Etem Arifi. Në këtë rast, sipas kryetares së KQZ-së, Valdete Daka, problematik mbetet një aktgjykim i vitit 2017, i Gjykatës Supreme, në rastin e Zafir Berishës kundër Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), që e ka detyruar KQZ-në ta rikthejë zotin Berisha në listën e kandidatëve. Ky aktgjykim specifikon se duhet edhe një vendim shtesë i gjykatës për ta ndaluar garimin në zgjedhje. Ky aktgjykim është në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet, i cili specifikon se asnjë person që ka dënim të plotfuqishëm në 3 vjetet e fundit nuk mund të kandidojë për zgjedhje të përgjithshme. "Fatkeqësisht, vendimi i Gjykatës Supreme ka qenë i detyrueshëm. Ne kemi vepruar në vitin 2017, i kemi decertifikuar më tepër se 80 kandidatë të cilët kanë qenë të dënuar me një vendim të plotfuqishëm. Mirëpo, fatkeqësisht, pas një ankese në vitin 2017, Gjykata Supreme na ka obliguar t'i kthejmë në listat e kandidatëve. Prandaj, derisa nuk ka ndonjë vendim tjetër, ose nuk jepet ndonjë verdikt tjetër nga Gjykata Kushtetuese, nuk mund të veprojmë vetë", tha Daka. Sidoqoftë, ajo tha se për rastin e deputetit Arifi nuk ishte në dijeni të vendimit të Gjykatës së Apelit, pasi për të njëjtin nuk ishte informuar as nga Këshilli Gjyqësor.

Por, përfaqësuesi i Këshillit Gjyqësor, Astrit Hoti, tha se KQZ-ja nuk i kishte kërkuar këtë informacion. Kjo seancë dëgjimore u mbajt online për shkak të pandemisë Covid-19. Në seancën dëgjimore gjykatësit

kanë parashtruar pyetje të shumta, të ndërlidhura kryesisht me procedurat për përfundimin e mandatit të deputetit, pasojat juridike: opsionet, shpallja e zgjedhjeve të reja apo rikthimi i procesit para dekretit të presidentit, mungesa e zinxhirit të përgjegjësive për njoftimin në kohë reale për aktgjykimet e plotfuqishme, integriteti i procesit zgjedhor dhe i Kuvendit, kërkesa e parashtruesit për shpalljen jokushtetuese të vendimit, pritjet e parashtruesit dhe përfaqësuesit e qeverisë etj. Gjykata Kushtetuese nuk ka dhënë afat se kur do ta shpallë aktgjykimin përfundimtar për këtë rast.

## Etem Arifi ende deputet

Pavarësisht se është në vuajtje të dënimit, Etem Arifi vazhdon ta mbajë pozitën e deputetit. Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, kishte kërkuar nga komisioni përkatës parlamentar për imunitete interpretim për rastin e tij. Në seancën e sotme dëgjimore të Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës, Shkëmb Manaj, tha se ka kërkuar interpretim nga Gjykata Kushtetuese. "Mund të konfirmoj se deputeti në fjalë tashmë pothuajse është afër përcaktimit të kohës prej gjashtë muajsh në vuajtje të dënimit, janë edhe disa ditë dhe Komisioni për Legjislacion mund të vihet në lëvizje me kompetencë që ta trajtojë kërkesën e kryetares së Kuvendit, tani pasi që t'i bëjë gjashtë muaj dhe t'i rekomandojë

Kuvendit që t'ia marrë ose mos t'ia marrë mandatin", tha Shkëmb Manaj.

Nga 29 shtatori deputeti i Partisë së Ashkalinjve për Integrim, Etem Arifi, është duke vuajtur dënimin pasi ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim për mashtrim me subvencione. Sipas vendimit të gjykatës, Etem Arifi, së bashku me Bajram Gashin, drejtor i OJQ-së "Zëri i Ashkalinjve", ishin përgjegjës për përvetësimin e rreth 26 mijë eurove. Në gusht të këtij viti Gjykata Themelore lëshoi urdhërarrest, por Arifi arriti t'i shmangej arrestimit. Ai iu drejtua edhe Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar mendim për ligjshmërinë e dënimit ndaj tij, por më 23 shtator Kushtetuesja njoftoi se nuk e ka marrë në shqyrtim kërkesën e Arifit, pasi e konsideroi si të papranueshme. Ndryshe, sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 70, mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm, ndër të tjera, nëse një deputet dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale me një ose më shumë vjet burgim.

Etem Arifi, pavarësisht se ishte i dënuar me vendim të formës së prerë, ai mori pjesë në seancën e 25 marsit, ku u rrëzua qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje. Po ashtu, ai ishte një nga 61 deputetët që më 3 qershor votoi për Qeverinë e re të Kosovës, të udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Pjesëmarrjen në votim të deputetit Arifi si dhe ligjshmërinë e qeverisë së drejtuar nga Avdullah Hoti e kontestoi Lëvizja Vetëvendosje e cila e ka dërguar këtë rast në Kushtetuese.



## QPD dhe QRA në Kaçanik dhe Zubin Potok pezullojnë ofrimin e shërbimeve me pale

KAÇANIK, 2 DHJETOR (ER)- Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Agjencia e Regjistrimit Civil ka njoftuar qytetarët se në Qendrën për Pajisje me Dokumente dhe Qendrën për Regjistrim të Automjeteve në Kaçanik dhe Zubin Potok, disa zyrtarë të këtyre Qendrave kanë rezultuar pozitiv me Covid-19.

Për shkak të rrezikut nga përhapja e Covid-19, është marrë vendim që Qendra për Pajisje me Dokumente dhe Qendra për Regjistrim të Automjeteve në Kaçanik dhe Zubin Potok, të pezullojnë ofrimin e shërbimeve me pale. Deri në përfundimin e procesit të testimit të stafit të këtyre qendrave, të gjitha

shërbimet e aplikimit për pajisje me dokumente, mund të bëhen nëpër Qendrat për Pajisje me Dokumente dhe Qendrat për Regjistrim të Automjeteve të komunave më të afërta për qytetarët. Përjashtim të rasteve të tërheqjes së dokumenteve të gatshme të cilat vazhdojnë të kryhen në QPD-në në Kaçanik dhe Zubin Potok.



## Zbulohet shtatorja e ish-presidentit Rugova në Istog



ISTOG, 2 DHJETOR (ER)- Të mërkurën në përvjetorin e ditës së lindjes së ish-presidentit, Ibrahim Rugova, u zbulua shtatorja e tij në Istog. Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti në ceremoninë e inaugurimit të Kompleksit Memorial "Dr. Ibrahim Rugova", tha se Istogut sot po i kthehet simbolikisht në

bronz djali i zgjedhur, të cilin ky qytet ia dha kombit, për ta shndërruar në prijës dhe burrështetas të parë të Republikës së Kosovës. Kryeministri Hoti nënvizoi se me urtësinë dhe largpamësinë e tij, ish-presidenti Rugova e traso i të ardhmen e Republikës së Kosovës. "Kërkesa e kamotshme e shqiptarëve të

Kosovës për mëvetësi u legalizua pikërisht nga LDK-ja dhe kryetari i saj i parë, dr. Ibrahim Rugova. Lidhja me botën perëndimore, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e tjera të NATO-s rezultoi vendimtare për shpëtimin e popullit të Kosovës nga gjenocidi serb më 1998 dhe 1999", ka theksuar Hoti.

## Rrahim Rexha, emërohet zëvendësues i drejtorit të përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike

VUSHTRRI, 2 DHJETOR (ER)- Rrahim Rexha, drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme emërohet zëvendësues i drejtorit të përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike. Ky vendim është marrë në mbështetje të nenit 10, paragrafi 2 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për

Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Rrahim Rexha, zëvendësues i drejtorit të përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, obligohet t'i kryejë të gjitha detyrat dhe përgjegjësit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.



## Së shpejti shpallen procedurat e tenderimit për autoudhën Kievë - Zahaq

PRISHTINË, 2 DHJETOR (ER)- Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka pritur në një takim pune drejtorin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në Kosovë, Neil Taylor, dhe Arianit Blakaj, bankier kryesor i këtij institucioni në Kosovë. Në takim u diskutuan projektet infrastrukturore që Ministria e Infrastrukturës i ka me Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, me theks të veçantë projektet e rëndësishme që lidhin Kosovën me vendet e rajonit. Ministri Abrashi ka falënderuar BERZH-in për mbështetjen e vazhdueshme në projektet infrastrukturore që janë duke u kryer, dhe po ashtu për ato që do të nisin shumë shpejt. Ministri Abrashi dhe

drejtori Taylor diskutuan për finalizimin e procedurave e përgatitjeve për shpalljen e tenderit për autoudhën Kievë-Zahaq, dhe së shpejti do të shpallen procedurat e tenderimit për këtë projekt strategjik për vendin. Po ashtu u diskutua për fillimin e projektit për zgjerimin e hyrje-daljeve në Komunën e Ferizajt, procesin e rehabilitimit dhe rikonstruktimit të hekurudhave të Kosovës si dhe bashkëpunimin e financimit e projektit të autoudhës, Prishtinë - Merdare.

Taylor bëri me dije se investimet e BERZH-it në Kosovë do të vazhdojnë, bazuar në kërkesat e Ministrisë dhe duke u përqendruar tek zhvillimi ekonomik i Kosovës.



# Edhe 14 të vdekur nga Covidi në Kosovë

Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të mërkurën edhe 555 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 340 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar edhe 14 viktima. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 324 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 25 910 raste, kurse numri i rasteve aktive është 13 722



## Hoti kërkon mbikëqyrje rigoroze të zbatimit të masave anti-Covid

Pas analizës së hollësishme me të gjitha institucionet kompetente për menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti ka kërkuar nga inspektorati, policia dhe shtabet komunale shtimin e angazhimit të përgjithshëm dhe zbatimin

rigoroz të masave për parandalimin dhe menaxhimin e situatës epidemiologjike me Covid-19. Kryeministri Hoti, në takim me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, atë Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender

Reçica dhe me përfaqësues të inspektoratit të policisë, atij farmaceutik, sanitar dhe inspektoratit shëndetësor, kërkoi përgatitje intensive dhe koordinim për mbikëqyrje të respektimit të masave anti Covid sidomos gjatë periudhës së festave të fundvitit.

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 2 DHJETOR-** Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 1 340 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 555 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 14 raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Ferizaj tri raste (82, 75, 69 vjeç), Prishtinë dy raste (77, 56 vjeç), Gjilan dy raste (82, 63 vjeç), Prizren një rast (76 vjeç), Gjakovë një rast (65 vjeç), Kamenicë një rast (70 vjeç), Istog një rast (78 vjeç), Suharekë

një rast (81 vjeç), Mitrovicë një rast (84 vjeç) dhe Viti një rast (78 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 40 672 raste nga 146 703 persona të dyshimë me këtë virus dhe 1 040 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 324 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 25 910 raste, kurse numri i rasteve aktive është 13 722.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 327 raste, Lipjan 32 raste, Fushë-Kosovë 27 raste, Mitrovicë 23 raste, Obiliq 21 raste, Prizren 21 raste, Podujevë 20 raste, Vushtrri 15 raste, Drenas 14 raste, Malishevë 12 raste, Suharekë 12 raste, Gjilan 7 raste, Graçanicë 4 raste, Kaçanik 4 raste, Gjakovë 3 raste, Skenderaj 3 raste, Ferizaj 2 raste, Istog 2 raste, Rahovec 2 raste dhe me nga 1 rast Kamenicë, Klinë, Pejë dhe Shtime.

# Reçica dhe Banka Botërore diskutojnë për mbështetjen e familjeve të varfra në Kosovë



**PRISHTINË, 2 DHJETOR (ER)-** Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në funksion të jetësimit të reformave të dikasterit që drejton, të mërkurën ka zhvilluar një takim virtual me drejtorin e Bankës Botërore për Kosovën, Massimiliano Paolucci dhe pjesën tjetër të ekipit të BB-së, ku kanë diskutuar për reformat e ndërmarra nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me theks të veçantë për Reformën Pensionale dhe vazhdimin e Reformës së Asistencës Sociale. Në këtë takim, ministri Reçica bashkë me ekipin e Bankës Botërore kanë diskutuar edhe

për procesin e fillimit të implementimit të projektit të BB-së, në vlerë prej 10 milionë euro, që për synim ka mbështetjen e familjeve të varfra në Kosovë.

Ministri i MPMS-së, Skender Reçica e ka falënderuar drejtorin e BB-së për Kosovë, për mbështetjen e madhe që ndër vite Banka Botërore i ka dhënë shtetit tonë dhe tani që po vazhdon të jep kontributin e saj, si në funksion të rimëkëmbjes ekonomike pas përhapjes së pandemisë, po ashtu edhe në mbështetje të procesit të reformave që ka ndërmarrë, si ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

## Ushtruesja e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, shërohet nga Covidi

**PRISHTINË, 2 DHJETOR (ER)-** Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani ka njoftuar se është shëruar nga Covid-19, dhe se është rikthyer në zyrën e

saj në Presidencë, për të vazhduar me angazhimet e saj. Ajo ka qëndruar dy javë në vetizolim dhe aktivitetet i ka zhvilluar kryesisht online. "Kam bërë thirrje

gjithnjë, e tani pas eksperiencës time dhe të familjes time me virusin, ju lutem sërish që të bëni kujdes të shtuar e të vazhdueshëm. Tashmë

virusi është çdokund. Ne ishim me fat ta luftojmë virusin me sukses, por, fatkeqësisht, ky nuk është fati i të gjithëve", ka shkruar Osmani në rrjetet sociale.





Deponia e mbetjeve minerare në Parkun Industrial në Mitrovicë

# Kosova, deponi mbeturinash minerare që përhapin helm

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

Berat Peci, i cili jeton në qytetin e Mitrovicës, çdo ditë ndihet i shqetësuar për shëndetin për shkak të ndotjes së ambientit nga deponia e Parkut Industrial në këtë qytet. Ky i ri tregon shqetësimin që ia shkakton ndotja e ambientit për shkak të mosmenaxhimit të duhur të këtyre mbetjeve metalike. “Si qytetar i Mitrovicës ndihem i shqetësuar nga deponia e mbetjeve minerare, duke pasur parasysh se qyteti ynë është i njohur për pasuritë që ka me plumb dhe zink. Mbetjet e tyre janë duke e dëmtuar organizmin e njeriut”, ka thënë ai.

Mungesa e menaxhimit të këtyre mbetjeve bën që Berati dhe shumë qytetarë që jetojnë në këtë rrethinë ta paguajnë me shëndet. “Këto mbetje nuk janë grumbulluar e sistemuar si

duhet. Një erë e rëndomtë kur fryn nga këto deponi të hapura, ngre lart një pluhur, i cili, edhe sipas konstatimeve të mjekëve, është i dëmshëm dhe kancerogjen.

Prandaj, industrializimin në qytetin tonë, në mungesë të menaxhimit të këtyre mbetjeve, e paguajmë me shëndetin tonë”, ka treguar Berat Peci.

Qytetarët e Kosovës, të cilët jetojnë në zonat përreth deponive të mbetjeve minerare të gjigantit metalurgjik “Trepça”, përballen me ndotje të ambientit nga këto mbetje, kontaminim të ujërave, të tokës si dhe helme të ndryshme që shkaktohen nga këto deponi.

Në Parkun Industrial të Mitrovicës në pjesën jugore gjendet deponia më e madhe e këtyre mbetjeve minerare të “Trepçës”, e cila zë 35 hektarë tokë dhe që ka grumbulluar rreth 42 mijë tonë mbetje. Mirëpo për

të shkuar deri te deponia e Parkut Industrial në Mitrovicë duhet hipur në një makinë pune të stërvjetruar të “Trepçës”, sepse rruga është jo e zakonshme. Me të arritur në deponi nga këto mbetje që datojnë prej dekadash, nën mëshirën e fatit dhe të kohës, sheh se toka ka marrë formë dhe ngjyrë tjetër. Duke shkelur mbi këto mbetje në çdo pëllëmbë toke që bën, nganjëherë të duket sikurse shkel në mbetjet minerare të Çernobilit dhe menjëherë të kaplon e dridhura se si do të ndikojnë këto në shëndetin e njeriut. Por, duke ndërruar hapat nga laramania e mbetjeve që kanë ngjyra të ndryshme, të duket sikurse je duke shkelur mbi arin e Kosovës nga ku të jepet ndjenja e snobistes. Nuk vonon shumë dhe ndjenja ndryshon. Pasi shkel mbi hapësirën që është shndërruar në baltë duke ndërruar hapat,

këmbe vetëm rëndohet dhe balta ngjitet në këpucë dhe ta vështirëson ecjen.

Fatkeqësisht kjo deponi nuk është e vetmja ku mbetjet minerare janë grumbulluar prej dekadash dhe fatin e njëjtë si të Beratit që jeton në një ambient të ndotur e kanë edhe shumë qytetarë të tjerë të cilët jetojnë përreth deponive në Stan Tërg, Artanë dhe Kishnicë, si dhe deponive të tjera që në hapësirën tonë, kanë sasi më të vogla mbetjesh.

Mbështetur në të dhënat që ka paraqitur UNDP-i në raportin “Menaxhimi i mbetjeve industriale të ndërmarrjes Trepça”, të vitit 2011, rezultojnë se ishin 42 mijë tonë mbetje vetëm në Parkun Industrial të “Trepçës”. Po sipas UNDP-së, në total llogaritet të jenë 67 500 000 tonë mbetje. Por, fatkeqësisht, kjo shifër nga atëherë e deri më tani mbetet enigmatike, pasi këto

mbetje nuk kanë pasur vëmendje nga autoritetet në saje të situatës së rëndë që ka kaluar “Trepça”, qoftë politike, për mungesë të ligjit apo zgjidhje të statutit të saj.

Historikun e shpërfilljes së ndotjes së ambientit nga këto mbetje na tregon edhe kryeshefi i “Trepçës”, Hysen Vrajolli. “Mbetjet datojnë qëkur ka filluar prodhimi në ‘Trepçë’. Në Stan Tërg mbetjet minerare riciklohen, kurse mbetjet minerare të Artanës deponohen në deponinë e Kishnicës. Këto mbetje janë ndotëse të ambientit, por kanë edhe vlerë monetare. Një pjesë e këtyre mbetjeve janë shitur në vitin 2009 dhe 2018. Aktualisht s’kemi shitje për shkak të pandemisë, pasi çmimet kanë rënë në bursën ndërkombëtare. Kam propozuar të bëhet një studim fizibiliteti që ta dimë efektin në ambient dhe sa mund të jetë





vlera monetare”, ka thënë Vrajolli.

Gjendja e rënduar financiare prej vitesh në “Trepçë”, e gjigantit më të madh fitimprurës në Ballkan, erdhi deri në situatën ku qeveria tash duhet t’i subvencionojë pagat e punëtorëve. Andaj, kjo

edhe ka bërë që çështja ambientale e rrezikut të ndotjes së ambientit nga këto mbetje të shpërfilllet në tërësi. Prandaj, mosdija e vlerës monetare të këtyre mjeteve bëri që këto mbetje të mbesin viktimë e kohës. Këtë na e thotë edhe Hysen Vrajolli, kryeshef i “Trepçës”, i cili, baraz me dëmin ambiental, llogaritë edhe vlerën monetare që mund ta kishin këto mbetje në rast se do të shiteshin. “Me shitje nënkuptojmë dy elemente: e para e pastrojmë ambientin, sepse kemi lumenj dhe tokë të ndotur dhe fitojmë mjete monetare që më pas do t’i investonim në miniera. Janë rreth 50 mijë tonë mbetje minerare vetëm në Parkun Industrial në Mitrovicë. Këto mbetje janë të zinkut prej metalurgjisë dhe prej flotacionit. Pos Parkut Industrial në “Trepçë”, janë dhe në Zvečan, Artanë dhe Kishnicë mbi 20 mijë tonë. Që gjithsejtë janë 60 mijë tonë”, ka pohuar ai.

Vrajolli ka treguar se vazhdimisht ka ankesa nga banorët e zonave ku janë këto mbetje për ndotje të ambientit. “Ka ankesa edhe nga banorët pasi këto mbetje janë ndotëse të ambientit dhe është e nevojshme të bëhet një zgjidhje për banorët dhe për përfitimet e “Trepçës”, ka thënë ai. Vrajolli ka bërë me dije se ka interesim nga kompani të huaja për t’i blerë këto mbetje. “Ne jemi të interesuar ta kemi së pari një studim fizibiliteti. Na duhet edhe ndihma ndërkombëtare, rreth 300 mijë euro për ta bërë studimin e fizibilitetit për këto mbetje. Ka pasur interesim nga kompani të huaja, si nga Anglia, Gjermania, Kina për blerjen dhe eksportimin e këtyre mjeteve”,

është shprehur ai.

E për pasojat ambientale të këtyre mbetjeve të cilat çdo ditë e më tepër po shënojnë rritje të grumbullimit ka folur ish-drejtor i “Trepçës”, Ferat Shala, i cili tani është deputet i Kuvendit të Kosovës. “Në pjesën e rajoneve ku gravitojnë këto mbetje, toka është e ndotur me metale të rënda nga mineralet e plumb-zinkut dhe mineralet e tjera dhe kryesisht zonat përreth janë të kontaminuara nga prania e metaleve të rënda. Pra, rajonet ku janë të vendosura këto deponi janë të ngarkuara me praninë e metaleve të rënda, plumb, zink, kalium dhe elemente të tjera, që janë ndotëse për tokën, ujin, ajrin e kështu me radhë”, ka thënë ai.

Edhe Shala thotë se duhet të bëhet një studim fizibiliteti për të vendosur më pas se çfarë duhet të bëhet me këto mbetje. Sipas tij, ky studim do t’u jepte rrugë më pas këtyre mbetjeve në aksin e sanimit të ndotjes ambientale. “Këto mbetje janë problem mjedisor tash e disa shekuj, por me theks të veçantë janë shpërfaqur si ndotëse në periudhat e fundit për shkak të ndikimit të tyre në çështjen e ujërave, të ajrit dhe të tokës. Parimisht, do të duhej që këto të sanoheshin pas një studimi të mirëfilltë i cili do ta përcaktonte shkallën e ndotjes për secilën deponi, por edhe vlerën ekonomike. Disa nga këto deponi industriale kanë vlerë të caktuar ekonomike dhe këtë vlerë e përcakton vetëm një studim i mirëfilltë shkencor i fizibilitetit për to. Pra, studimi do të jepte një pasqyrë reale si për leverdinë ekonomike, po ashtu edhe për shkallën e ndotjes dhe

për mënyrën e sanimit apo rehabilitimit”, u shpreh ai.

Meqenëse në këto deponi ka mbetje të plumbit, zinkut dhe metaleve të tjera të rënda, nga ekologu Mixhen Maxharri konsiderohen radioaktive. Ai thotë se potencialisht një ndryshim klimatik, si rasti i vërshimeve, do të na çojë në një katastrofë ambientale dhe humanitare pasi, sipas tij, këto mbetje minerare do të derdhën në lumenj përreth, meqë përreth pendës së deponive nuk ka asnjë lokalizim që mund ta parandalonte katastrofën ambientale, kur dihet se përreth deponive të “Trepçës” gjenden lumenjtë si në Sitnicë, Ibër dhe Lumi i Marevcit.

Ekologu Maxharri ka treguar edhe për rreziqet potenciale që mund t’i kanosen shëndetit të njeriut, botës bimore dhe shtazore nga ndotja ambientale. “Mbeturinat industriale, toksike, radioaktive, minerale, me bazë të metaleve të rënda, janë kategori e veçantë e ndotjes së mjedisit që shkaktojnë ndotje në të gjithë botën, rrjedhimisht edhe në Kosovë. Në këtë kontekst deponia inerte e minierës së “Trepçës” nuk bën përjashtim nga deponitë e tjera që kanë mbetur të patrajtuara e të cilat paraqesin rrezik për ambientin, shëndetin dhe botën e gjallë që i rrethon. Deponia në hyrje të Mitrovicës që llogaritet se ka deri në 50 mijë tonë mbetje minerare paraqet rrezik në aspektin e ndotjes së mjedisit”, ka theksuar ai, duke përmendur sferat që mund të rrezikohen nga këto mbetje. “E para për shkak se gjendet afër Lumit Sitnica ekziston rreziku që jonet, mbetjet e metaleve, helmuese,

radioaktive të përfundojnë në lumë si pasojë e mjedisit të jashtëm, erërave, borës apo edhe vërshimeve. Pra, duke bërë helmimin e botës së gjallë që mund të shkaktojë vdekje masive dhe ujin e bën të papërdorshëm në kuptimin biologjik”, ka pohuar ai.

Maxharri ka përmendur edhe aspekte të tjera që paraqesin rrezik në aspektin e ndotjes së mjedisit. “Aspekti tjetër është ndotja e tokës si pasojë e reshjeve, rrjedhës së joneve helmuese në tokë që paraqet problem zinxhiror si kultivimi i bimëve, ushqimi i bagëtive. Në këtë mënyrë vjen deri tek akumulimi i helmeve në trupa shtazorë, rrjedhimisht që helmi shkon në organizmin e njeriut. Po ashtu, efekti i toksikeve që kalon në ajër dhe mund të ketë ndotje radioaktive që mund t’i kenë metale të rënda si zinku, plumbi, e që ndikojnë në shëndet dhe shkaktojnë sëmundje kancerogjene dhe deratogjene që ndikojnë në fetusin e nënave dhe shfaqin pasojë embrionale”, ka deklaruar ai.

Por ana e dhimbshme e ndotjes ambientale bëhet edhe më e madhe kur autoritetet më të larta sikurse Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, e cila ka në domenin e vet “Trepçën”, nuk ka dhënë dritë jeshile që problemi i këtyre mbetjeve të zgjidhet në një të ardhme të afërt. Në këtë ministri thonë se mbetjet kanë vlerë ekonomike, por duhet të bëhet fizibilitet real mbi vlerën reale të tyre, e tek pastaj ato që kanë vlerë ekonomike të valorizohen. “Mbetjet janë të sistemuara në vendet në të cilat në të kaluarën ka pasur aktivitet minierar dhe teknologjik. Mbetjet kanë qenë në menaxhimin e AKP-së deri në vitin 2016, kur është miratuar Ligji për Trepçën. Në planin e biznesit për vitin 2021, pikë me prioritet është parashikuar rivlerësimi i pasurisë së Trepçës. Në këtë kuadër hyn edhe rivlerësimi i mbetjeve teknologjike dhe industriale.

Sipas informacioneve nga NP “Trepça Sh.A”, mbetjet kanë vlerë ekonomike, por duhet të bëhet fizibilitet real mbi vlerën reale të tyre, e pastaj ato që kanë vlerë ekonomike të valorizohen, kurse mbetjet e tjera të trajtohen me projekte bashkëkohore sipas standardeve të BE-së”, është thënë në përgjigjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Sipas kësaj ministrie, për impaktet ambientale nga mbetjet minerare duhet të kyçen shumë institucione dhe kjo çështje duhet të vlerësohet nga shumë parametra të cilët ndikojnë në florën dhe faunën përreth deponive, sidomos atyre që janë buzë lumenjve, që ndikimi i aktivitetit të erozionit bartet edhe në shtretër të lumenjve, si në Sitnicë, Ibër, Lumi i Marevcit etj.

Pos komunikimit të mëparshëm që Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit kishte me përfaqësues



Deponia e mbetjeve minerare në Parkun Industrial në Mitrovicë

të "Trepçës" rreth përpjekjeve për valorizimin, asgjë konkrete deri më tani nuk është bërë në këtë drejtim. "Po në vitin 2013 kemi angazhuar një kompani për ta realizuar projektin 'Mundësitë dhe mënyrat e rikultivimit të deponive dhe vendburimeve të shfrytëzuara minerale', ku janë identifikuar të gjitha deponitë e mbetjeve minerare, duke përfshirë edhe ato të 'Trepçës Sh.A', ku janë paraqitur mundësitë e rikultivimit të tyre. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit konsideron që për impaktet ambientale nga mbetjet minerare duhet të kyçen shumë institucione dhe kjo çështje të vlerësohet nga shumë parametra të cilët ndikojnë në florën dhe faunën përreth deponive, sidomos atyre që janë buzë lumenjve e që ndikimi i aktivitetit të erozionit bartet edhe në shtretër të lumenjve, si në Sitnicë, Ibër, Lumi i Marevcit etj. Nga koha kur 'Trepça' është regjistruar si Shoqëri Aksionare, nga kjo ndërmarrje kemi informacionin se janë bërë përpjekje për valorizimin e tyre, por deri më tani nuk kemi diçka konkrete", është theksuar në përgjigjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Nuk duhet harruar se përderisa në vendet e zhvilluara me nano-teknologji këto mbetje gjejnë përdorim dhe hyjnë në procesin e multiplikimit dhe prodhimit, në Kosovë, pos barrës ambientale, nuk sjellin asnjë përfitim ekonomik. Kjo bën që në aspektin e ambientit ne vazhdojmë të jemi larg hapave dhe politikave të Bashkimit Evropian (BE). "Një ndër sfidat më të mëdha në udhëtimin drejt familjes evropiane është edhe

ambientalizmi. Fatkeqësisht, në këtë drejtim Kosova ka ngecur. Është brengosëse pasi ekzistojnë deponi të shumta të këtyre mbetjeve dhe është rrezik permanent për ambientin dhe për qytetarët e Kosovës. Në kuadër të 'Trepçës' ekzistojnë disa deponi të metaleve dhe mineraleve të ndryshme të cilat duhet të analizohen në disa dimensione të ndryshme, si dimensionin ekonomik dhe ambientalist, prandaj është e pajustificueshme se pse këto deponi nuk janë shitur kur e dimë se kishte kompani të interesuara qoftë nga Turqia apo vendet evropiane, që këto mbetje t'i importojnë në vende të ndryshme", ka thënë sekretari gjeneral në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste të Italisë, Safet Gërzhaliu.

Ai ka folur edhe për përdorimin e tyre nga vendet e zhvilluara. "Derisa koncentratit i 'Trepçës' shitët si scrub apo mbeturina, në vendet evropiane dhe aziatike me nano-teknologji i prodhojnë më shumë se 30 metale dhe katrogjene. Në këtë drejtim sa më shpejt duhet të zbardhen e të shiten dhe nga të përfitojnë ambienti dhe ekonomia. Në Kosovë avancimi i prodhimit lë për të dëshiruar. Në Kosovë këto mbeturina janë duke prodhuar amortizim dhe janë duke e ngulfatur ambientin", ka theksuar Gërzhaliu.

Meqenëse nga java në javë e nga dita në ditë gjendja në "Trepçë" ndryshon për shkak të telasheve financiare dhe politike, çdo qeveri që vjen në pushtet ndërton bordin dhe menaxhmentin. Në këtë këndvështrim as që shihet dritë e gjelbër në fund të tunelit për



*Deponia e mbetjeve minerare në Parkun Industrial në Mitrovicë*

pastrim apo sanim të mbetjeve minerare. Kishim një javë plot me dramacitet në këtë ndërmarrje, pasi minatorët kishin hyrë në grevë brenda në minierë për shkak të vonës së pagave. Si rrjedhojë e kësaj gjendjeje, Qeveria e Kosovës u dashtë t'i subvencionojë pagat e minatorëve në vlerë 1.1 milion euro. Po ashtu, kryeshefi Hysen Vrajolli dha dorëheqje nga kjo pozitë, me arsyetimin se kishte pasur presion qeveritar për mungesë të performancës. Nga ana tjetër, kemi paralajmërime nga pala serbe, se çështja e "Trepçës" duhet të jetë sërish debat në tryezën e dialogut që po

zhvillohet në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel. Të gjitha këto bëjnë që çështja ambientale të shpërfilllet në tërësi. Prandaj, ambientalistët, ndërkombëtarët dhe autoritetet vendore njëzëri duhet të ngrehën në këmbë që çështjen ambientale nga këto deponi ta sanojnë, në mënyrë që ta shpëtojnë ambientin dhe shëndetin e njeriut dhe të botës bimore dhe shtazore.

Deri në zgjidhjen e këtij problemi që, fatkeqësisht, lë shumë për të dëshiruar, qytetari nga Mitrovica, Berat Peci, por edhe qindra qytetarë në zonat përreth këtyre deponive do ta kenë të kontaminuar ambientin,

rrjedhimisht edhe shëndetin e rrezikuar.

(Ky shkrim i gazetares Albulena S. Mavraj ka fituar çmimin e parë për gazetari, me temë nga fusha e energjisë dhe ambientit, me shkrimin "Kosova, deponi mbeturinash minerare që përhapin helm". Ky shkrim është punuar në kuadër të programit për gazetarë në fushën e energjisë dhe mjedisit, zbatuar nga Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS), me mbështetjen e qeverisë gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ)



*Minatorët në grevë si shkak i mosmarrjes së pagave për muajin tetor, 2020*

# Gjykata Speciale, provimi më i vështirë në 20 vjetët e fundit i diplomacisë së Shqipërisë dhe Kosovës



**Nga Msc. Iur. Anton LULGJURAJ, Mal i Zi**

Lufta e Kosovës për liri ishte e shenjtë. Gjithë Perëndimi u vu në lëvizje për të ndihmuar një popull ndaj të cilit po bëhej gjenocid dhe krime kundër njerëzimit. Në krye të të gjithë këtij aksioni ishte ShBA dhe Britania e Madhe, pastaj vinin shtetet aleate. Serbia po përballlej me humbjen më të madhe në historinë e saj. Lufta e Kosovës varrosi Jugosllavinë dhe ndarja e Malit të Zi nga Serbia varrosi konceptin e Serbisë së Madhe.

Po çfarë ndodhi gjatë luftës së vitit 1998-1999? Dua të ndaloj tek një gjë, pasojat e të cilës po gjunjëzojnë reputacionin ndërkombëtar të Kosovës.

Atë botë, Serbia përveç se po bënte luftë duke tentuar spastrimin etnik të Kosovës, bënte edhe grumbullin e "fakteve" të cilat sjellin të pandehur krerët më të lartë të ish-UÇK-së përpara një gjykate penale ndërkombëtare në Hagë, përkatësisht Dhomave të Specializuara pranë kësaj gjykate.

Çfarë janë Dhomat e Specializuara? Dhomat e Specializuara funksionojnë në bazë të ligjeve përkatëse të Kosovës, të drejtës zakonore ndërkombëtare si dhe të drejtave ndërkombëtare të njeriut (neni 12 i Ligjit të Dhomave të Specializuara). Pas një raporti të datës 7 janar 2011 të paraqitur në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës nga senatori zviceran Dick Marty, në shtator të të njëjtit vit BE-ja themelon Task Forcën Hetimore Speciale (TFHS), për të vërtetuar pretendimet e nxjerra nga ai Raport. Fatkeqësisht, ky Raport, u votua edhe nga Shqipëria në KE, pa asnjë arsye! Serbia "festoi" për votën e palës shqiptare. Kosova tani më kishte rënë edhe brenda kësaj humnere pa dritë për momentin.

Kuvendi i Kosovës miraton marrëveshje ndërkombëtare me BE-në (23 prill 2014), më 3 gusht 2015 miraton amandamentin kushtetues (nenin 126) dhe Ligjin për

Dhomat e Specializuara (DHS) dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS), për të vënë në jetë këtë proces tej mase enigmatik dhe tendencioz, me qëllimin e vetëm që të "vërtetohet pasthirrma 20-vjeçare e Serbisë që: "UÇK-ja është organizatë kriminale dhe terroriste". Periudha që do të jetë objekt gjykimi është 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000 (neni 7 i Ligjit për DHS).

Serbia duket se është kujdesur jashtëzakonisht mirë për të mbledhur "çdo provë" mbi tokë e nën tokë, vetëm që të dërgojë si të akuzuar për krime luftime dhe krime kundër njerëzimit krerët më të lartë të UÇK-së. Dhe ia arriti. Pas 9 vitesh, ata ndodhen në Hagë.

Deri tani kemi 7 vetë të akuzuar, por nuk përjashtohet mundësia të ketë edhe të tjerë, madje me shtetësi të ndryshme të cilët akuzohen për krime në territorin e Kosovës/ish Republikës së Jugosllavisë (IRJ) gjatë viteve 1998-2000. Këtë përfundim e nxjerrim nga neni 9/2 i Ligjit për DHS të cilin po e paraqes këtui: "... përveç juridiksionit të tyre territorial të paraparë në nenin 8, Dhomat e specializuara kanë juridiksion mbi personat e nënshtetësisë kosovare/IRJ apo mbi personat që kanë kryer krime në kuadër të juridiksionit të tyre lëndor kundër personave me nënshtetësi kosovare/IRJ kudo që janë kryer ato krime".

Akuzat që u bëhen të pandehurve janë nga më të rëndat të cilat po i paraqes më poshtë:

Krimet kundër njerëzimit: përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme, zhdukje me forcë

e personave.

Krime luftime: arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë, vrasje e paligjshme.

Po çfarë u vu re në seancat e para të Dhomave të Specializuara? U përmend dhe u akuzuan të pandehurit edhe për pjesëmarrje në organizatë kriminale! "Organizatës kriminale" nuk ia përmenden emrin. Por, është botërisht e njohur se sipas Beogradit zyrtar, UÇK-ja është organizatë e tillë, ndërsa të gjithë të akuzuarit kanë qenë anëtarë dhe drejtues të lartë të UÇK-së. Këto fjalë u cituan nga Prokuroria e Specializuar pranë kësaj gjykate. Si mundet që dikush të akuzohet për pjesëmarrje në një organizatë kriminale, pa ia thënë emrin organizatës në fjalë? Ose Prokuroria mbi ç'bazë përmend organizatën kriminale? Kënd quan Prokuroria "organizatë kriminale"? E quan UÇK-në? Atë UÇK që e përkrahi gjithë Perëndimi?

## Retrospektivë:

Plani sekret i Millosheviqit 1989-1999 për Kosovën ishte shfarosja e popullit shqiptar në të cilin thuhej:

Në Kosovë toka e djegur duhet të përfshijë të gjitha anët e saj; Tymi i vatrave shqiptare të dëshmojë se ato vise janë fikur përgjithmonë;

Kufomat e karbonizuara dhe shtëpitë e bëra shkumb të shkaktojnë trishtim vdekjeprurës;

Botës t'i themi: po i vrasim se po na detyrojnë;

Toka e Shën Savës duhet të hakmerret. Shqiptarët i pastron

vetëm thika dhe zjarri. (Kisha Serbe).

Të mos ndërmarrësh hapa konkret institucional, në momentin që zbulohen mbi 16 vend varrime masive në Serbi me shqiptarë të Kosovës, është të kalosh në heshtje padrejtësitë dhe gjenocidin që Serbia ka bërë në Kosovë dhe të bëhesh palë me krimin. Ndërkohë, ditët e fundit qeveria Serbe refuzon të flas për këto vend varrime masive me shqiptarë. Kjo tregon që e kaluara e tyre dhe e tashmja janë "një". Minimalisht do duhej autoritetet më të larta serbe, nëpërmjet një deklaratë zyrtare të bënin "Mea culpa".

## Konkluzionet dhe përfundimet

Raporti i Dick Martyt është votuar në Këshillin e Evropës edhe nga Republika e Shqipërisë! Mbi ç'bazë? Ky votim duhet qartësuar! Prokuroria Speciale ka material në dorë të përbërë nga dhjetëra e dhjetëra mijëra faqesh ndaj të pandehurve!

Edhe nëse vetëm njërit ndaj të akuzuarëve u vërtetohen akuzat, do përdoret nga Serbia dhe aleatët e saj se UÇK-ja ka qenë organizatë kriminale dhe do fillojë lobimi që botërisht lufta e Kosovës të njihet si e gabuar, pa kërkuar rikthimin e Serbisë në Kosovë. Në këtë mënyrë do vështirësohet rruga e Kosovës për të vërtetuar në Gjykatë ndërkombëtare se ndaj saj Serbia ka bërë gjenocid dhe kjo e fundit nuk ka detyrime për reparacione luftime!

Nga viti 2011 deri në vitin 2020, Republika e Shqipërisë nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të

ndihmuar Kosovën për këtë proces duke neglizhuar si përherë, e ndoshta edhe nga mos dija, për kurthin e përgatitur mirë nga Beogradi! Nën akuzë është edhe ish Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi i cili është propozuar për "çmimin nobel" dhe paradoksi qëndron që aktualisht akuzohet për krime luftime dhe krime kundër njerëzimit. Presidenti i zgjedhur amerikan Joe Biden e ka quajtur z. Thaçi "Xhorxh Uashingtoni i Kosovës".

E çfarë duhet të bëjë Kosova e Shqipëria zyrtare?

Republika e Kosovës duhet të arrijë pajtimin kombëtar dhe për 1 mandat të tërë mos të bëjë fare garë politike, por të unifikohen për të mbrojtur ish krerët më të lartë të UÇK-së që gjenden në Hagë;

Republika e Kosovës duhet të krijojë fond të veçantë për mbrojtjen e të akuzuarëve në Dhomat e Specializuara;

Kosova duhet të gjejë mënyrë nëpërmjet rrugëve diplomatike dhe Diasporës së ShBA-së që të vihet në lëvizje Shtëpia e Bardhë për të mbrojtur denjësisht të akuzuarit në DHS; Republika e Shqipërisë duhet të rishikojë mardhëniet diplomatike me Serbinë.

Shqiptarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit duhet të jenë ura lidhëse ndërmjet dy shteteve, kurse Kosova është pika e padiskutueshme. Pra, nuk mund të kemi mardhënie me Serbinë duke nëpërkëmbur Kosovën.

Nuk mund të ndërtojmë të ardhme me inate personale Berisha - Thaçi dhe Rama - Haradinaj. Për më tepër kur dalin dhjetra varre masive me trupa shqiptarësh në territorin e Republikës së Serbisë. Populli serb ka krijuar jetën mbi trupat e shqiptarëve që gjenden në tokën dhe nëntokën e Serbisë. BE heshtë!

Republika e Shqipërisë duhet të ngre zërin për Kosovën dhe situatën konkrete në: Këshillin e Evropës, OKB, BE, NATO, Uashington, Bruksel dhe Berlin.

Republika e Shqipërisë duhet të miratojë buxhet të veçantë për të përkrahur Kosovën në Dhomat e Specializuara; Shqipëria dhe Kosova duhet të dërgojnë kërkesa në Uashington, Bruksel, Londër, Berlin dhe Romë, që të fillojnë procedurat në dhomat përkatëse legislative të këtyre vendeve, për të njohur zyrtarisht gjenocidin serb mbi popullin shqiptar të Kosovës.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Peja regjistron fitoren e katërt radhazi



**PEJË, 2 DHJETOR** - Skuadra e Pejës e ka shënuar fitoren e katërt radhazi në Prince Caffè Superligë, pasi e mposhti sot skuadrën e Bashkimit me rezultat 76:59 (21:19, 20:14, 22:18, 13:8). Çereku i parë i sfidës ishte i baraspeshuar, derisa pejanët e përmbyllën me dy pikë epërsi 21:19. Por, "verdhezinjtë" ngritën epërsinë në periudhën e dytë, duke treguar lojë më të mirë në parket për të fituar këtë pjesë 20:14, dhe shkuan në pushim me rezultat 41:33. Përkundër tentimeve nga mysafirët, Peja fitoi edhe periodën e tretë, 22:18, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 63:51. 10 minutat e fundit ishin

vetëm formalitet (13:8) dhe Peja triumfoi në fund me shifrat 76:59. Dardan Berisha ishte më i dalluari te Peja me 26 pikë, tetë kërcime e shtatë asistime, kurse te Bashkimi më i miri ishte Musab Mala me 20 pikë, 10 kërcime e katër

### PRINCE CAFFÈ SUPERLIGA - JAVA 4

Peja - Bashkimi 76:59

Të enjten takohen:  
15:00 Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli

Superliga e Femrave - Java 4

Të enjten takohen:  
16:30 Kosovahome Prishtina - Penza

asistime. Peja ka katër fitore në katër ndeshje, ndërsa Bashkimi një fitore dhe katër humbje. Ndërsa sot (e enjte) do të zhvillohet ndeshja ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Golden Eagle Yllit. "Bardhekaltrit" kanë një fitore dhe dy humbje në këtë edicion, kurse therandasit tri fitore dhe një humbje. Ndeshja do të zhvillohet të enjten në palestrën "Don Bosko". Po ashtu në mesjavë zhvillohet ndeshja e mbetur e xhiros së katërt në Superligën e Femrave, Kosovahome Prishtina-Penza. Të dy skuadrat kanë nga tri fitore dhe tri humbje në këtë edicion deri më tani në elitën e femrave.

### SHKURT

#### Sot Drita përballlet me Llapin

Ndeshja e mbetur e javës së parë në Superligën e Kosovës në futboll, ndërmjet Dritës dhe Llapit, do të zhvillohet sot (e enjte), në stadiumin e qytetit në Gjilan nga ora 13:00. Kjo ndeshje ishte shtyrë për shkak të pjesëmarrjes së Dritës si kampione e Kosovës në garat evropiane. Drita aktualisht pas 13 ndeshjeve të zhvilluara zë pozitën e dytë me 30 pikë, derisa Llapi pas 14 ndeshjeve të luajtura ka 11 pikë në pozitën e parafundit.

#### Rashani infektohet me koronavirus

Sulmuesi i Përfaqësues së Kosovës në futboll, Elbasan Rashani ka dalë pozitiv në testin për koronavirus dhe do të jetë i izoluar deri më 9 dhjetor. Siç raporton klubi i tij Odd, Rashani dhe dy futbollistë tjetër kanë shkallë të vogël të simptomave. Rashani 27-vjeçar këtë edicion në elitën e futbollit të Norvegjisë ka shënuar dy gola dhe ka kontribuar me gjashtë asistime në 20 paraqitje.

#### Xhudistët vazhdojnë përgatitjet në Austri

Përfaqësuesja e Kosovës në xhudo aktualisht po stërvitet në Austri me synime për të realizuar planin e punës drejt Olimpiadës. Driton Kuka përmes një postimi në "Facebook" ka shkruar se puna atje po vazhdon rregullisht pavarësisht disa probleme që kishin pasur për udhëtim jashtë vendit. "Kampi stërvitor në Austri po vazhdon! Përkundër shumë vështirësive për udhëtim jashtë vendit ne po arrijmë të realizojmë planin e punës drejt Olimpiadës! Dua të veçoj ndihmën nga Ambasada e Kosovës në Vjenë, Ambasadorin Pllana miken tonë Shkurten dhe mbarë stafin për mbështetje në çdo moment për ekipin tonë! Kosova dita ditës po rritet si shtet i fuqishëm në çdo aspekt! #tokyo2020plus1", ka shkruar Kuka.

#### Rrahmani shërohet nga koronavirusi

Kapiteni i Përfaqësues së Kosovës, Amir Rrahmani ka dalë negativ për Covid-19 në testin e kryer së fundmi. Ai tashmë gëzon shëndet të plotë dhe klubi i Napolit bën me dije se mbrojtësi i Kosovës ka kryer vizitat fizike të mërkurën dhe mjekët kanë dhënë lejen për të nisur stërvitjen të enjten. Rrahmani pati rezultuar pozitiv pas kthimit nga grumbullimi i nëntorit me "dardanët". Rrahmani pritet të jetë në listën e Gattuso për ndeshjen e nesërme kundër AZ Alkmar.

#### Zidane: Nuk e kam menduar dorëheqjen

Pas humbjes 2-0 në Ukrainë përballë Shakhtar Donetsk, Reali i Madridit ka komplikuar ecurinë në Ligën e Kampioneve, ndërsa bankina e Zinedine Zidane është lëkundur sërish, por vetë francezi deklaroi se as që e çon nëpër mend dorëheqjen. "Nuk e kam menduar dorëheqjen. Kemi pasur momente të komplikuar dhe një situatë vërtetë të keqe në aspektin e rezultateve, megjithatë duhet të shohim përpara. E dinim që sot do të ishte një finale dhe e kishim përgatitur mirë. Bëmë një pjesë të parë shumë të mirë, por nuk arritëm të shënojmë, megjithatë kemi edhe një ndeshje dhe duhet ta fitojmë patjetër", ka thënë Zidane.

## Giannis Antetokounmpo: LeBron më i miri në botë, një ditë dua të luajmë së bashku

**MILWAUKEE, 2 DHJETOR** - Giannis Antetokounmpo është shpallur dy sezonet e fundit basketbollisti më i mirë në NBA në sezonin e rregullt, duke marrë trofeun MVP. E megjithatë, skuadra e tij Milwaukee Bucks nuk ka

mundur të shkojë në finalen "play-off". Basketbollisti grek shprehet se ka një admirim të madh për LeBron James, që e fton të luajë tek ekipi i Bucks: "Nëse LeBron vjen këtu, apo ndonjë lojtar tjetër i madh, për mua nuk ka rëndësi nëse

qëndrojnë në stol, unë dua të fitoj". "LeBron është basketbollisti më i mirë në botë dhe për mua do të jetë një nder të luaj me të ndonjë ditë. Kur unë të jem më i miri do ta them pa frikë, por për momentin ai është më i miri. Për mua është një

model", ka deklaruar Giannis. "Luan prej 17 vitesh në NBA dhe asnjë nuk ka folur keq për të. Bën punën e tij dhe vazhdon të fitojë. Nëse do të kisha mundësi të votoja për trofeun MVP do t'i jepja votën time", ka thënë Giannis Antetokounmpo.



## Shkëndija ruan kreun, Shkupi merr vendin e dytë

**TETOVË, 2 DHJETOR** - Fitore e thellë për Shkëndijën e Tetovës në javën e 14-të të kampionatit të Maqedonisë së Veriut. Skuadra e Ernest Gjokës bindi në duelin direkt për kreun ndaj Makedonija Gj.P duke ruajtur vendin e parë në renditje falë suksesit 5-0 që arriti në Tetovë, raporton "Supersport". Pas dy barazimeve Shkëndija u rikthye te suksesi duke u ngjitur në kuotën e 30 pikëve, katër më shumë tashmë se Makedonija Gj.P dhe 2 më pak se skuadra tjetër shqiptare e Shkupit që u ngjiti në vendin e dytë. Ernest Gjoka mbeti shumë i kënaqur nga kjo sfidë pasi ndaj Makedonija Gj.P shënuan të gjithë sulmuesit. 16-vjeçari Elezi zhbllokoi shifrat pas vetëm 10 minutash lojë, ndërkohë që në fundin e pjesës së parë kishte vend për golat e Doriev dhe Besart Ibrahimit. Në fundin e takimit Shkëndija shënoi edhe dy herë të tjera me Valmir Nafiu i ardhur në fushë nga stoli dhe Totren. Shkupi nga ana e tij triumfoi 3-1 ndaj Belasicas me dy gola të gambianit Darboe dhe finalizimin e kosta-rikanit Alvarez. Ndryshimi në stol i ka bërë mirë Renovës që iu largua fundit të renditjes falë fitores së



dytë radhazi këtë herë në fushën e Akademija Pandev në Strumicë me rezultatin 0-1. Në javën e 14-të me rezultat minimal Rabotnicki mposhti 1-0 Pelister ndërsa Sileks kaloi me

të njëjtat shifra Vardarin e Shkupit. E vetmja skuadër shqiptare që nuk mori rezultat pozitiv në këtë raund ishte Struga që u mposht 2-1 në transfertën ndaj Borec.

## Berisha shtrohet në spital për shkak të Covidit

**FERRARA, 2 DHJETOR** - Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, është shtrirë në spital në Itali, për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore pas infektimit me Covid-19. Portieri i klubit italian SPAL, Berisha u infektua me koronavirus derisa ishte në detyrë me kombëtaren kuqezi para rreth dy javëve. Ai ka qenë në izolim por pas përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, ai është dërguar në spital në departamentin e specializuar për Covid-19 në rajonin Emilia-Romagna. Lajmi është bërë i ditur nga vetë skuadra italiane në uebsajtin e klubit. "SPAL njofton se pasi testit të fundit pozitiv për COVID-19 të premtën më 27 nëntor, portieri i skuadrës kaltërebardh, Etrit Berisha, është dërguar në departamentin e specializuar për COVID-19 në Spitalin Cona për teste mjekësore", thuhet në njoftimin e SPAL.



### SHKURT

#### Djali i Michael Schumacherit vitin tjetër garon në Formula 1

Në sezonin e vitit 2021 një Schumacher do të bëjë gara në Formula 1. Djali i Michael Schumacherit, Micku ka nënshkruar një kontratë me skuadrën e Haas. Ai do të jetë i gatshëm ta tregojë veten në sezonin e ardhshëm në garat e Botërorit të ardhshëm. I biri i kampionit të shtatëfishtë në "Formula 1" ka qenë mjaft i suksesshëm në garat e nivelit më të ulët. Ai po konsiderohet si një hap i madh drejt kalimit në Ferrari në një sezon më të afërt.

#### Përballja mes Joshuas dhe Pulevit zhvillohet me tifozë

Sfida e madhe e boksit në kategorinë e peshave të rënda në mes anglezit Anthony Joshua dhe bullgarit Kubrat Pulev do të zhvillohet me praninë e tifozëve. Mediet në Angli kanë raportuar se autoritetet lokale kanë lejuar që tifozët të jenë të pranishëm në rast se ndjekin rregullat e caktuara ndaj pandemisë Covid-19. Në këtë përballje do të lejohen 1 mijë tifozë teksa sfida do të zhvillohet në "SSE Arena". Ky meç ishte paralajmëruar që të zhvillohej kanë pasur plan të përballen në qershor, por ndeshja është shtyrë shkaku i pandemisë së koronavirusit. Joshua do provojë të mbrojë titujt si IBF, WBA, WBO dhe IBO kundër Pulev me 12 dhjetor.

#### Roberto rezulton pozitiv me Covid

Telashet për skuadrën e Barcelonës nuk po ndalen, pasi përveç lëndimit të disa futbollistëve sot pozitiv në testin për Covid ka dalë edhe mbrojtësi Sergi Roberto. Klubi nga "Camp Nou" ka njoftuar se futbollisti në fjalë është mirë më shëndet dhe do të jetë dy javë i izoluar. Dje është raportuar se pas telasheve në vijën e fundit, Barcelona ka shfaqur interesim për transferimin e futbollistit shqiptar Shkodran Mustafi.

#### Pioli e mposhti Covidin

AC Milan po kalon një moment fantastik teksa udhëheqin të vetëm Serie A, plus pikë nga Interi. Kuqezinjtë në këtë periudhë janë drejtuar nga Daniele Bonera në një kohë kur si trajneri Pioli ashtu dhe ndihmësi i tij, Giacomo Murelli, ishin të prekur nga Covid-19. Më në fund, trajneri Pioli dhe ndihmësi i tij mund të zbresin në stërvitje pasi të dy kanë rezultuar negativ në testin e fundit që iu nënshtruan të martën.

#### Kolumbia shkarkon trajnerin Carlos Queiroz

Carlos Queiroz nuk do të drejtojë më Kombëtaren e Kolumbisë. Ish-trajneri i Real Madridit dhe Portugalisë vendosi mbylljen e bashkëpunimit me Federatën e Futbollit të këtij vendi pas humbjes turpëruese 6-1 me Ekuadorin në eliminatorët e Kupës së Botës 2022. Lajmi u bë i ditur nga Federata Kolumbiane e Futbollit. "Për Federatën Kolumbiane të Futbollit ishte krenari të kishte Keirozin si trajnerin e kombëtares për dy vite, në të cilat ai dha gjithë kapacitetin e tij, përvojën dhe njohuritë e tij", thuhet në komunikatën e FKF-së.

Kur fakti politik bëhet pjesë e historisë, e në e vëzhgojmë atë me një distancë të ftohtë, Xhevdet Bajraj na e shpërndan atë të konvertuar në një fabul të shkëlqyer. *Cuando el hecho político pasa a formar parte de la Historia, y lo observamos con fría distancia, Xhevdet Bajraj nos lo entrega convertido en una espléndida fábula*

Héctor Carreto, poet, meksikan. - *Poeta mexicano*

Imazhet që ai evokon janë të pastra dhe të bukura, me pak njerëz, si plagë të thella e të pastra. Kur përktheja këto imazhe unë u përpoqa ta kap pafajësinë e tyre, bukurinë e tyre fëmijërore, e cila bie kaq shumë në kontrast me makthe të errëta të kujtesës së Bajrajt

*Las imágenes que evoca son limpias y hermosas, con poca gente, como heridas profundas y limpias. Al traducir estas imágenes, intenté capturar su inocencia, su belleza infantil, que contrastan de manera tan marcada con las oscuras pesadillas de la memoria de Bajraj*

Alice Whitmore, përkthyesë e poezisë së Bajrajt nga gjuha spanjolle në angleze, Australi. - *Traductora de la poesía de Bajrajt del español al inglés, Australia*

Zëri që na detyron t'i modifikojmë kategoritë tona dhe referencat ndaj dhunës, tmerrit, vdekjes, braktisjes, vetmisë, e cila në këtë Amerikën tonë Latine (kaq e prirë për të shpallur dhimbje që nga heroina e romantizmit) ka qenë pretexti i poezisë pamfletuese të oportunitetit lirik

*Voz que nos obliga a modificar nuestras categorías y referencias para con la violencia, el horror, la muerte, el abandono, la soledad, que en esta nuestra Latinoamérica (tan proclive a anunciar el dolor desde la heroína del romanticismo) ha sido pretexto de pamphletarias poesías de oportunismos líricos*

Carlos Pineda, poet dhe eseist meksikan. - *Poeta y ensayista mexicano*

Poezia e Xhevdet Bajrajt nxit stuhi asociacionesh të lexuesit, e shkëput atë nga realiteti trivial dhe e strehon në një realitet të ri ku mbretëron meditimi për çështje substanciale të jetës, për botën, vetminë, dhimbjen dhe rrugëtimin e njeriut në jetë

*La poesía de Xhevdet Bajrajt estimula la tormenta de asociaciones en el lector, lo separa de la realidad trivial y lo cobija en una nueva realidad donde reina la meditación sobre cuestiones sustanciales de la vida, sobre el mundo, la soledad, el dolor y el viaje del hombre en la vida*

Zyrafete Shala, kritike letrare. - *Crítica literaria*

Poezi e dinjitetit mbi gërmadha. - *Poesía de dignidad sobre ruinas.*  
Shqiptar Oseku, poet. - *Poeta*

6.99 €



ISBN 978-9951-780-09-4

KAFE ME NËNËN  
CAFÉ CON MAMÁ

XHEVDET BAJRAJ



XHEVDET BAJRAJ

KAFE ME NËNËN poeziCAFÉ CON MAMÁ poesia

Parathënien/ Prólogo: Adil Olluri



Adem Gashi (1953), poet, prozator dhe eseist, pa lënë mënjane njohuritë e paskajshme të tij për letërsinë shqiptare dhe për atë botërore, ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar mësues dhe ka qenë redaktor

reviste, drejtor televizionit, themelues i PEN-it të Kosovës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bursist i fondacionit gjerman "Heinrich Böll-Stiftung", këshilltar i lartë politik, drejtor i Zyrës për Komunikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Është anëtar i revistës *Akademia* dhe anëtar i Këshillit Drejtues i Institutit Albanologjik. Ka botuar 24 libra dhe është nderuar me rreth 50 çmime letrare. Është prezantuar në dhjetë antologji të lirikës shqipe. Edhe pse që dy vjet ka mbushur moshën e pensionistit, krijimtarinë letrare s'ka ndër mend ta pensionojë.

Libri i katërt me tregime, me rrëfenja e me parabola i Adem Gashit, *Lakorja e fatit*, dëshmon dhe ridëshmon autorin si krijues po aq të fuqishëm edhe në prozë. Madje tani mund të vlerësohet se toka e begatë e shkrimtarit, në kuptimin cilësor të vlerave artistike dhe të hijeshisë dhe të kënaqësisë estetike, është tregimtaria.

*Lakorja e fatit* çilet me tregimin uverturë *Pëllumbi i paqes* i rimarrë nga libri me titullin omonim (*Pëllumbi i paqes*, 1989), për të lakuar strukturisht tre kapitujt pasues: *Terr, Dritë dhe mjegull* dhe *Matanë*, të cilët, në aspektin e konceptimit mbarështrues të tyre, na e vizatojnë kurbën tematike dhe motive, ideore dhe përmbajtësore, filozofike dhe psikanalitike jo vetëm të rrëfimitarëve tregimtarë, por edhe të gjenit krijues të autorit. Në këtë rast, besoj, vlen të veçohen dy aspekte: poetika moderniste me elemente të postmodernizmit dhe gërshetimi i formave dhe zhanreve letrare siç, fjala vjen, i prozës (tregimi, rrëfenjat), i poezisë (një lirikë me dy parabola poetike dhe një rrëfenjë-parabolë) si dhe i dramës, i konceptuar në trajtë të antidramës (*Maja e gishtit të madh të perandorit*).

4.99 €



ISBN 978-9951-780-06-7

Dr. Emin Z. Emini

LAKORJA E FATIT

ADEM GASHI

ADEM GASHI

LAKORJA E FATIT  
(Tregime, rrëfenja dhe parabola)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Komuna Dragash/Opština Dragaš/Dragas Municipality  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM DRAGASH



Nr-13/764  
Data 02.12.2020  
Dragash

Ne pajtim me autorizimet dhe përgjegjësit të cilat i ka Drejtoria e Arsimit mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit, merr këtë:

Njoftim !

Për anulimin në tërësi të konkursit për mësimdhënës  
Nr.13/696 në pikën 3.mësuese klasor në shfmu "Svetelost" "Krushevë"

I

Anullohet, procedura e rekrutimit për vendet e punës sipas konkursit të shpallur publik për mësues klasor në shfmu "Svetelost" nr-13/696 i datës 06.11.2020

II

Anulimi i konkursit nga pika i e këtij njoftimi bëhet për shkak objektivë, komisioni rekrutues — përzgjedhës, nuk ka arritur që brenda afatit të parapare prej pesëmbëdhjete (15) ditëve të shpalle rezultatet e testit me shkrim në pozitën mësues klasor në shfmu "SVEILOST" Krushev sipas nenin 10 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Anulimi i konkursit, bëhet me rekomandim të komisionit përzgjedhës.

III

Për zbatimin e këtij njoftimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit

Dragash 02.12.2020

DKA –Dragash

## SHPLLJE

**Biznesi SH.P.K "EURO ART" me numer Unik Identifikues Nr.810199704 , Shpallë njoftimin se bënë ndrrimin e STATUTIT te dates 01.12.2015. Duke plotësuar të dhënate reja si dhe korigjimin e gabimit te Stautit të më hershëm si:**

- Ndërrimin e shumës së gjithëmbarshe të kapitalit themelorë fillestarë nga 500,000.€ në 5,000.€
- Ndërrimi i Agjenti të regjistruar nga Bajram Haziri me Nr. ID. 1012566448. Tashë bëhet Ardit Haziri me Nr.ID.1240443933

## >> SHPLLJE TË VOGLA <<

► Gramoz Berisha shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së dhjetë të shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► "F-MAX" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810195083

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

